

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 11
16.06.2011

NR. VENDIMI 6
20.06.2011

V E N D I M

“SEKUESTRIMIN E PASURISE “

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

Gjyqtar : Gurali BRAHIMLLARI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ermira Terbuni** sot, ditën e Hënë, më dt.**20.06.2011**, ora **08.30**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqësore jo publike kerkesen penale me:

KERKUES: Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda - Xxxxx, Perfaqesuar nga Prokurori E. N. .

KUNDER: **Te hetuarve:**
1.A. D., i biri i Y. dhe i M., i dtl xx.xx.xxxx,
lindur dhe banues ne xxxxxx.
2. Y. D., i biri i T. dhe i I. , i dtl xx.xx.xxxx,
lindur dhe banues ne xxxxxx.

OBJEKTI: **Sekuestrim i pasurive**

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit NËpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Prokurori pretendoi pranimin e kërkesës, Sekuestrimin e pasurisë ndërtesë tre katëshe, Bar – Restorant - Hotel “xxxx”, e ndodhur në Komunën xxxx, fshati xxxxxx, e ndërtuar mbi pasurinë e sekuestruara tokë arë me numër pasurie xx/x me sipërfaqje xxxx mx dhe pasurisë nr xx/x/x, me sipërfaqje xxx mx, në pronësi të shtetasit Y. D.

Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit e Rrethit Kavaje si dhe per administrimin dhe perdorimin e ketyre pasurive ngarkohet administratori V. P. prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Gjykata si mori në shqyrtim aktet e provat e paraqitura nga prokurori

KONSTATON SE

Kërkesa është e drejtë e duhet të pranohet sipas objektit të saj.

Rezulton se Prokuroria e rrethit Gjyqësor Kavaje me date 26/11/2009 ka regjistruar procedimi penal nr.363 ndaj shtetasve A. D dhe Y. D , te cilet jane duke u hetuar per vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga hetimi i atij organi ka rezultuar nder te tjera se shtetasit A. D e Y. D , kane kryer trasferta te shumta bankara nga jashte shtetit si dhe disponojne pasuri te cilat nuk justifikohen me aktivitetin e ligjshem te tyre.

Rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor - Kavaje, ne datën 01/06/2010 ka percjelle aktet në Prokurorinë për Krime të Rënda – Tiranë, me qëllim fillimin e procedurave të hetimit pasuror, ndaj dy personave te sipercituar te cilet jane nen hetim per konsumimin e vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale, parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Mbi kete baze provohet se ne date 15/06/2010, Prokuroria për Krime të Rënda - Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr. 11 në ngarkim të shtetasve A. D dhe Y. D ne perputhje me parashikimin e neneit 3/1/d i K.Penal sepse jane duke u hetuar per vepren penale te “Pastrimit të parave” vepër e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Pra prokuroria pretendohet se te hetuarit A. D dhe Y. D , ne baze te neni 3/1 germa “d” jane dhe subjekte te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Rezulton se për këta shtetas Prokurori për Krime të Rënda ka kërkuar fillimisht sekuestrimin e disa pasurive të verifikuara si në pronësi të tyre dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dhënë vendimin nr 11 datë

22.09.2010 sipas te cilit janë vënë në sekuestro pasuritë si vijon: “

1. Sekuestrimi i llogarise ne emer te shtetasit Y. A. D. prane Raiffeisen - Bank, me nr.xxxxxxxxxx, në shumën **5, 486, 100** (*pesemilione e katerqinde e tetedhjete e gjashtemije e njeqinde*) *leke*.
2. Sekuestrimi i llogarise, ne emer te shtetasit Y. A. D. , prane Raiffeisen - Bank, me nr.xxxxxxxxxx, në shumën **1, 813.17** (*njemilione e teteqinde e trembedhjete mije e shtatembedhjete*) *leke*,
3. Sekuestrimin e llogarise se celur prane Raiffeisen - Bank, ne emer te shtetasit Y. A. D. me nr.xxxxxxxxxx, në shumën **20, 660** (*njetemije e gjashteqinde e gjashtedhjete*) *euro*,
4. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Bankes Popullore**, ne emer te shtetasit Y. A. D. , me nr.xxxxx, *në shumën 578.57* (*peseqinde e shtatedhjete e tete presje pesedhjete e shtate*) *leke*,
5. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Bankes Popullore**, ne emer te shtetasit Y. A. D. , me nr.xxxxxx, në shumën **505.69** (*peseqinde e pese presje gjashtedhjete e nente*) *euro*,
6. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Bankes Popullore**, ne emer te shtetasit Y. A. D. , me nr.xxxxxx, në shumën **15.000.000** (*pesembedhjete milione*) *leke*,
7. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Bankes Popullore**, ne emer te shtetasit A. D. , me nr.xxxxxx, *në shumën 1.83* (*nje presje tetedhjete e tre*) *euro leke*,
8. Sekuestrimin e depozites me afat prane **Bankes Popullore**, ne emer te shtetasit A. D. , me nr.xxxxxx, në shumën **11,000,000** (*njembedhjete milione*) *leke*,
9. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Bankes Popullore**, ne emer te shtetasit A. D , me nr.xxxxxx, në shumën **100, 500** (*njeqinde mije e peseqinde*) *euro*,
10. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Tirana - Bank**, ne emer te shtetasit Y. A. D. , me nr.xxxxxxxxxxxx, në shumën **176, 465, 87** (*njeqinde e shtatedhjete e gjashte mije e katerqinde e shtatedhjete e pese presje tetedhjete e shtate*) *leke*,
11. Sekuestrimin e llogarise se celur prane **Tirana - Bank**, ne emer te shtetasit Y. A. D. , me nr.xxxxxxxxxxxx, *në shumën 63, 767, 64* (*gjashtedhjete e tremije e shtateqinde e gjashtedhjete e shtate presje gjashtedhjete e kater*) *leke*,
12. Sekuestrimin e pasurise 72/8/1, volumi 6, faqe 70 Arre me siperfaqe xxx mx, ne emer te shtetasit Y. D. .
13. Sekuestrimin e pasurise 72/5, volumi 5, faqe 181, Arre me

- siperfaqe xxxxxxx m x, ne emer te shtetasit Y. D. .
14. Sekuestrimin e pasurise 71/3 volumi 1, faqe 226, Arre me siperfaqe xxxx mx, ne emer te shtetasit Y. D. .
etj.”

Rezulton se ky vendim ka marrë formë të prerë dhe se tashmë është në gjykim kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda me objekt konfiskimin e këtyre pasurive.

Gjatë ekzekutimit të këtij vendimi për sekuestrimin e pasurive të sipërcituara , Prokurori pretendon se administratori i pasurisë ka konstatuar personat që dyshohen si subjekte të ligjit parandalues, kanë edhe një pasuri tjetër të cilën nuk mund ta justifikojnë me të ardhurat e ligjshme që sigurojnë. Kështu sipas prokurorit rezulton se, njga verifikimi në vend, mbi pasurinë e sekuestruar tokë arë, me numër xx/x, me sipërfaqje xxxxx mx dhe mbi pasurisë xx/xx me sipërfaqje xxx mx, gjëndet i ndërtuar një hotel, me tre kate, që quhet Hotel “xxxx” dhe se edhe kjo pronë është e subjekteve pronarë të tokës së sekuestruar, prandaj akuza kërkon sekuestrimin edhe të kësaj prone.

Orani i prokurorisë pretendon se te hetuarit Y. D dhe A. D. bazuar dhe ne nenin 3/2 të Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, janë subjekte të këtij ligji, ndaj dhe pasuritë e tyre te evidentuara se jane ne disponimin e tyre, duhet qe ti nënshtrohen procedurës së sekuestrimit sipas ligjit te mesiperme.

Prokurori pretendon se ndonese ndaj te paditurve A. e Y. D., nga ana e Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Kavajë , me vendim të datës 28.02.2011 është vendosur pushimi i çështjes objekt i procedimit penal nr 295 të vitit 2009, sepse nuk janë gjëndur elementët e figurës së veprës penale të “pastrimit të produkteve të krimit” sipas nenit 287 të K.P. , nuk ka pengese për të vijuar hetimi pasuror dhe për të marra masa parandaluese kundër pasurisë së tyre.

Per me teper prokurori pretendon se te pandehurit jane te lire dhe ekziston rreziku real dhe potencial që pasurite e mesiperme te tjetërsohen, apo te humbasin, prandaj ne baze te nenit 11/1 te ligjit te sipercituar ato duhet te sekuestrohen ne perputhje me nenin 3/1 germa “d” te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”**.

Per te provuar pretendimet e tij perfaqesuesi i akuzes Prokuroi E. N. paraqiti për shqyrtim këto prova shkresore:

- Proces verbal per kqyrjen dhe marrjen e provave materiale, datë 03.06.2011.
- Çertifikate per vertetim pronesie, date leshimi 05.03.2003, ne mer te Y. , T. D. , se bashku me hartën perkatese;
- Formular aplikimi te kerkeses per regjistrim dhe leshim certifikate;

- Çertifikate per vertetim pronesie, date leshimi 16.04.2010, ne mer te Y. T. D. , se bashku me harten treguese e regjistrimit;
- Formular aplikimi te kerkeses per regjistrim dhe leshim certifikate;
- Çertifikate per vertetim pronesie, date leshimi 20.11.2010, ne mer te Y. T. D. , se bashku me harten treguese e regjistrimit;
- Formular aplikimi te kerkeses per regjistrim dhe leshim certifikate;
- Fature tatimore shitje, me nr.01. date 31.12.2007;
- Shkrese me dergim dokumentacioni nga Bashkia Rrogozhine, nr. 968 Prot, date 27.12.2006;
- Mandat arketimi nr. 939, date 27.12.06;
- Leje shfrytezimi date 27.12.2001 leshuar nga zyra e urbanistikes se Bashkise Rrogozhine;
- Vendim i KRRT nr.30, date 04.07.2003 nga keshilli rregullimit te territorit Bashkise Rrogozhine, sekretaria teknike e KRRT;
- Preventiv, gjithsej 4 faqe;
- Deklarate noteriale nr. 404 Rep, nr.158 Kol, date 25.02.2008;
- Planimetria e sheshit te ndretimit te objektit Bar-Hotel i shtetasit Y. D., gjithsej 7 faqe;
- License me nr. 1754/2;
- Situacion per punimet e kryera per periudhen mars, Prill dhe maj 2004, gjithsej 2 faqe;
- Shkrese nr.787 prot, date 30.05.20011 e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara;
- Shkrese nr.1058 Prot, date 18.11.2010 e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara;
- Raport mbi marrjen ne dorezim te pasurive te sekuestruara te shtetasve A. D. dhe Y. D. , e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara;
- Proces verbal i veprimeve permbarimor gjate ekzekutimit, date 03.11.2010, e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara Kavaje;
- Proces verbal i veprimeve permbarimor gjate ekzekutimit, date 03.11.2010, e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara Kavaje;
- Proces verbal i veprimeve permbarimor gjate ekzekutimit, date 03.11.2010, e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara Kavaje;

- Proces verbal i veprimeve permbarimor gjate ekzekutimit, date 12.11.2010, e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara Kavaje;
- Proces verbal i veprimeve permbarimor gjate ekzekutimit, date 12.11.2010, e Ministrise se Financave, Angjensia e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara Kavaje, gjithsej 3 faqe;
- Shkrese nr.5 Akti , date 08.11.2010 per dergim fotokopjte e vendimit nr.11 date 22.09.2010;
- Vendim nr.11, date 22.09.2010 i Gjykates per Krime te Renda Tirane, per sekuestrimin e pasurise se shtetasve A. D. dhe Y. D. ;
- Vendim per kryerjen e kqyrjes, date 30.05.2011;
- Vendim per pushimin e ceshtjes objekt i procedimit penal nr.295 te vitit 2009, date 28.02.2010;

Gjykata si degjoi pretendimet e prokurorit dhe shqyrtoi provat e mesiperme konkludon se, ne baze te neneit 3/1/d te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, te hetuarit A. dhe Y. D. jane subjekte te ligjit parandalues sepse per te ka dyshime te arsyeshme te mbeshtetura ne prova se kane konsumuar elemente te vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepes penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Rezulton e provuar se ndaj ketyre personave eshte rregjistruar nje procedim penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje dhe ndonese ky procedim është pushuar me vendimin e datës 28.02.2011, Gjykata bazuar ne nenin 5 te ligjit parandalues vlereson se kerkesa e prokurorit dhe procedura e sekuestrimit konfiskimit te pasurive sipas ligjit parandalues, nuk varen nga gjendja e shkalla e procedimit penal. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se bazuar në nenin 24/2 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009, masat parandaluese ndaj pasurisë të të dyshuarve Y. D. dhe A. D. , për përfshirjen në veprimtarinë e mësipërme kriminale mund të vijojnë.

Vec kësaj, Gjykata bindet në ekzistencë e provave dhe të indicjeve për përfshirjen e të paditurit A. D. në veprimtari kriminale të asaj natyre që ligji parandalues mund të veprojë sepse nga akte e fashikullit të gjykim e provat e paraqitura nga akuza, provohet se në kuadër të këtij procedimi penal për hetimin e veprës penale të “opastrimit të produkteve të krimet”sipas nenit 287 të K.Penal, Prokurori e Rrethit Kavajë, ka kërkuar e paraqitur nëpërmjet letërporosisë, një vendim penal i Gjykatës së Vicencas Itali me nr 577 datë 04.10.2000.

Sipas këtij vendimi, rezulton se i padituri A. D. është gjëndur

fajtor dhe është dënua për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese” në dëm të dy shtetaseve shqiptare; se këtë vepër kriminale ai e ka kryer në periudhë Dhjetor 1999 deri në Prill 2000, vepër penale e cila parashikohet edhe nga neni 114/a i K.Penal si dhe është në listën e veprave penale për të cilat vepron ligji parandalues sipas nenit 3 të tij.

Bazuar në nenin 10 të K.Penal Gjykata vlerëson se Vendimi penal nr 577 datë 04.10.2000 i Gjykatës së Vicencas Itali, vlen edhe për “shlyetjen e dëmit dhe efekte të tjera civile”

Ne baze të provave të marra e shqyrtuara në seance gjyqësore, gjykata vlerëson se kërkesa e akuzës për sekuestrimin paraprak të pasurive të evidentuara prej këtij organi në pronësi të hetuarve Y. dhe A. D. është e drejte e duhet të pranohet.

Ne baze të nenit 11/a të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, nisur edhe nga vlera e kësaj pasurie si dhe fakti se pasuriotë e të dyshuarit A. D. janë në proces konfiskimi, Gjykata vlerëson ekzistencën realë për tjetërsimin e kësaj pasurie të paluajteshme që disponojnë aktualisht të hetuarit Y. dhe A. D. , prandaj për këto pasuri duhet të vendoset masa e sekuestrimit.

Ne baze të nenit 12/2 të ligjit të sipërcituar masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë 6 muajore.

PER KETO ARSYE

Gjykata në baze të neneve 3/1/d; 11/a, 12 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë duke urdheruar: Sekuestrimin e pasurisë të ndërtesës tre katëshe, bar – Restorant Hotel “Advin”, e ndodhur në Komunën Lekaj, fshati Harizaj, e ndërtuar mbi pasurintë e sekuestruara tokë arë me numër pasurie 72/5 me sipërfaqje 1000 m² dhe pasurisë nr 72/8/1, me sipërfaqje 625 m², në pronësi të shtetasit Y. D. .

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit e Rrethit Kavaje si dhe për administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive ngarkohet administratori V. P. pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tirane.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim brenda afatit të parashikuar në K. Pr.Civile në Gjykatën e Apelit për Krimet e Renda Tirane.

U shpall në Tirane sot me dt. 20.06.2011 ora.08.50.

SEKRETARE

ERMIRA TERBUNI

GJYQTARI

GURALI BRAHIMLLARI

